



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 388/2010

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga Muhamet Rexha kryesues, Ferid Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, për shkak të mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur më 12.12.2010, mori këtë:

## V E N D I M

**MIRATOHET** ankesa si e bazuar e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje.

Aleancës Kosova e Re (AKR), i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 3400 (tremijëekatërqind) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A r s y e t i m

Subjekti politik LVV, ka parashtruar ankesë më të cilën pretendon se subjekti politik AKR, ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, më datë 08.12.2010 në orën 19:50 në rrugën “UÇK” në Prishtinë duke i mbuluar posterin e subjektit politik LVV.

PZAP-i ka pranuar një ankesë më datë 09.12.2010, nga subjekti politik LVV të cilës ia kanë bashkangjitur një fotografi si dëshmi, në të cilën shihet qartë se posterin e kandidatit Ibrahim Makolli nga radhët e subjektit politik AKR, është vendosur mbi posterat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja.

**Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:**

PZAP-i e informoi subjektin politik AKR, më datë 09.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 10.12.2010, gjerë në ora 12:00. PZAP-i, nuk pranoi përgjigjeje në ankesë nga subjekti politik AKR, sipas afatit të caktuar.

## **Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike**

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim:*

a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;

### **Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve**

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

*Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:*

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

**- ankesa është e bazuar.**

PZAP-i vlerëson se AKR, shkeljet e kësaj natyre i ka përsëritur në vazhdimësi, andaj konsiderohet si recidivist e cila rrethanë ndikon në lartësinë e dënimit të shqiptuar me gjobë.

Prandaj nga këto arsye dhe më qëllim të evitimit të shkeljes së lartcekur po ashtu në pajtim më dispozitat e lart cekura ligjore, PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar, e lidhur me nenin 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

A nr. 388/2010 më datën 12.12.2010

